

VENDIM
Nr. 308, datë 10.4.2013

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 1719, DATË 17.12.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT
PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45 të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregullat e ankandit publik, miratuar me vendimin nr. 1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në kreun VI “Kushte të përgjithshme për zbatim”, në pikën 6 shkronja “c”, ndryshohet dhe pas saj shtohet shkronja “ç”, si më poshtë vijon:

“c) Kur për objektet e ankandit të shpallura dy herë për shitje, sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë ofertë për blerjen e tyre, autoriteti shitës cakton një VAM tjetër më të ulët se VAM-i fillestar. Ulja e VAM-it bëhet 20%.

ç) Në procedurën e hapur, kur autoriteti shitës nuk ka vendosur asnjë kërkesë të veçantë për kualifikim, sipas procedurave të këtij vendimi dhe nuk është paraqitur asnjë ofertë për blerje, në vijim të procedurës së parashikuar në shkronjën “c” të kësaj pike, autoriteti shitës cakton një VAM tjetër 20% më të ulët se VAM-i i përcaktuar në shkronjën “c” të kësaj pike. Në rast se edhe pas kësaj uljeje, nuk paraqitet asnjë ofertë për blerje, VAM-i ulet deri 20% nga VAM-i i fundit, për çdo shpallje, derisa vlera të arrijë 30% të VAM-it fillestar të ankandit.

Përfshihet nga kjo procedurë shitja në ankand e pasurive të paluajtshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha